



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

LIGJI PËR MBROJTJEN E MJEDISIT

Kuvendi i Kosovës,

Në mbështetje të Rregullores nr.2001/9 të dt.25 maj 2001 Për Kornizën Kushtetuesetë Vetëqeverisjes së Përkohshme në Kosovë, veçanërisht nenet 5.1 (f), 5.7, 9.1 .26 (a), 9.3.3, 11.2 dhe tutje;

Duke parë nevojën për të sjellë standarde mbi mjedisin në Kosovë në harmoni me ato të Bashkimit Europian;

Të dedikuar pas qëllimit për të mundësuar një mjedis të shëndetshëm në rritje për popullin e Kosovës;

Duke patur parasysh së vënja e standardeve të tilla dhe krijimi i një mjedisi të tillë duhet të formohet në mënyrë që të jetë konform me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe që Kosova të mund të përballojë harxhimet e tilla; dhe,

Me qëllim krijimin e bazës së kornizës ligjore që do të (i) mundësojë një mjedis të shëndetshëm në rritje gjatë sjelljes graduale të standardeve të Bashkësisë Europiane për mjedis, (ii) sigurojë që për krijimin e një mjedisi të tillë mund të përballohen shpenzimet dhe është konform me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, (iii) krijojë kompetencat dhe detyrimet e autoriteteve publike që janë përgjegjëse për sjelljen dhe fuqizimin gradual të standardeve të tilla, dhe (iv) japë të drejtat dhe detyrimet e personave dhe ndermarjeve që preken nga aktivitete të tilla ose intereset që promovojnë një mjedis të shëndetshëm në Kosovë;

Nxjerr Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit, si vijon:

KAPITULLI I: **DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

Neni 1

Qëllimi i Ligjit

1. Qëllimi themelor i këtij ligji është krijimi i bazës për kornizën ligjore që do të promovojë një ngritje të mjedisit të shëndetshëm për popullin e Kosovës me sjelljen graduale të standardeve për mjedis të Bashkimit Europian.
2. Gjithashtu, qëllim themelor i këtij ligji është që të sigurojë atë se krijimi i një mjedisi të tillë është arritur në mënyrë që është e përballueshme dhe konform me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik.
3. Ky ligj identifikon autoritetet publike që do të bëjnë implementimin e një apo më shumë dispozitave të këtij ligji, krijimin e autoriteteve specifike dhe detyrimet e secilave autoritete publike që dalin nga ky ligj. Ky ligj gjithashtu do të përcaktojë të drejtat dhe detyrimet e personave apo ndërmarrjeve të prekura nga aktivitetet e autoriteteve të tilla publike apo me persona të interesuar për promovimin e mjedisit të shëndetshëm në Kosovë.

Neni 2

Përkufizimet

Sipas këtij Ligji zbatohen përkufizimet si vijon:

- (a) “Kuvendi” do të thotë trupi legjislativ i themeluar në pajtim me nenin 1.5(a) dhe 9.1 të Rregullores të UNMIK-ut 2001/9 “Për Kornizën Kushtetuese të Vetëqeverisjes në Kosovë .
- (b) “Çrregullim kritik për mjedisin” është nocion i përgjithshëm që ka të bëjë me ndotjen, mbeturinat ose pëlherat që i tejkalojnë nivelet kritike të parapara me këtë ligj ose aktet normative të nxjera në pajtim me këtë ligj.
- (c) “Dëm i mjedisit” do të thotë një gjë apo aktivitet që ka potencial të jashtzakonshëm dhe të dukshëm që ta dëmtojë mjedisin në mënyrë substenciale, apo të bëjë një aksident mjedisor.
- (d) “Degradim” ose “Degradim i mjedisit” do të thotë degradim substencial i mjedisit (në atë shkallë që ndikon në kualitetin e jetës), nga ndotja, mbeturinat dhe pëlherat ose nga përdorimi apo shfrytëzimi i paautorizuar i burimeve natyrore.
- (e) ”Aksident ekologjik” do të thotë një ndodhi e papritur që ndodh nga vis majore ose qëllime të tjera të paparapara dhe rezulton në gjendje të madhe akute me kohëzgjatje të shkurtër, nga mbeturina apo materie të dëmshme që në mënyrë të qartë i kanosen shëndetit publik ose i shkaktojnë dëm mjedisit.
- (f) “Pëlqim mjedisor” do të thotë autorizim me shkrim i nxjerrë në pajtim me këtë ligj, që në rethana të përsëhruara me këtë ligj ose akte normative të nxjera në pajtim me këtë ligj, më qëllim marjen e lejes për ndërtim.

- (g) “Vlersimi i ndikimit në mjedis” (“VNM”) do të thotë vlersimi për të determinuar dëmet e mundshme mjedisore nga ndërtimi dhe aktivitete të tjera zhvillimore.
- (h) “Dëm mjedisor” do të thotë impakt negativ substencial në kapacitetin regjenerativ të mjedisit ose shkatrimin të një ekosistemi specifik.
- (i) “Inspektor mjedisor” do të thotë personi që ka autorizimet e duhura me këtë ligj apo aktet normative të nxjera nga ky ligj, të bëjë inspektimin e zhvillimeve dhe aktiviteteve të tjera si dhe determinimet preliminare reth konformitetit apo jokonformitetit të aktiviteteve me të tilla me këtë ligj apo akte normative të nxjera në pajtim me këtë ligj.
- (j) “Inspektoriati i mjedisit” do të thotë institucionin e themeluar nga ky ligj.
- (k) “Leja mjedisore” do të thotë autorizimi me shkrim që është lëshuar në pajtim me këtë ligj apo me një akt normative të lëshuar si pauses të këtij ligji, në rethan të përshkruara me këtë ligj apo në një akt normative të nxjerë nga ky ligj, që kërkohet në mënyrë që të meret një leje veprimi.
- (l) “Bordi këshillues për mbrojtjen e mjedisit” do të thotë bordi i themeluar me këtë ligj.
- (m) “Çrregullim i madh mjedisor” është një term i përgjithshëm që ka të bëjë me ndotjen, mbeturinat dhe plehërat që i tejkalojnë kufijtë e caktuar nga ky ligj .
- (n) “Qeveria” do të thotë Qeverinë e themeluar sipas nenit 1.5(c) dhe 9.3 të Rregullores të UNMIK-ut 2001/9 “Mbi Kornizën Kushtetuese për Vetqeverisjen e Përkohshme në Kosovë” dhe çdo Qeveri pasardhëse ose autoritet qendror ekzekutiv.
- (o) “Mbeturina të rrezikshme” do të thotë dëmi nga shoqëria që (i) shfaq rezik domethënës për shëndetin njerzor apo mjedisin kur nuk menaxhohet në mënyrë adekuate, (ii) është i ndezshëm, koroziv, reaktiv ose toksik, dhe (iii) është klasifikuar si i rrezikshëm nga BE-ja.
- (p) “Fondi i Kosovës për Mjedis” apo “Fondi” do të thotë Fond i themeluar ne bazë të këtij ligji.
- (q) “Agjensioni i Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit” (“AKMM”) do të thotë Agjensioni Brenda Ministrisë i cili gjithatë përshkruhet në nenin 39. të këtij ligji.
- (r) “Akt normativ” do të thotë çdo rregullore e UNMIK-ut apo ligj që ka fuqi normative në Kosovë.
- (s) “Akt plotësues normativ” do të thotë një direktivë administrative, udhëzim administrativ apo çdo akt tjetër që ka fuqi normative në Kosovë dhe që është miratuar nga një autoritet publik në bazë të autoritetit të dhënë nga një akt normativ.
- (t) “Akt i veçantë”do të thotë parimet, procedurat, rregullat , normat apo standardet e caktuara që nxjerren nën autoritetin e këtij ligji. Kur ky ligj i jep autoritet Qeverisë për të miratuar akte , ato duhet të jenë Direktiva Administrative , Instruksione Administrative ose akte tjera që Qeveria është e autorizuar ti nxjerr në bazë të këtij ligji, ligjeve të tjera ose rregulloreve të UNMIK-ut .Kur ky ligj i jep autoritet Ministrit për të miratuar akte të veçanta, ato duhet të jenë instruksione Administrative ose akte të tjera që Ministri është i autorizuar ti nxjerr në bazë të këtij ligji , ligjeve të tjera ose rregulloreve të UNMIK-ut. Kur

ky ligj i jep autoritet komunave për të miratuar akte të veçanta, ato duhet të jenë akte që Komuna është i autorizuar ti nxjerr në bazë të këtij ligji, ligjeve të tjera ose rregulloreve të UNMIK-ut. Kur ky ligj i referohet akteve të veçanta pa deleguar ndonjë autoritet përgjegjës për nxjerrjen e akteve të tilla kjo përfshin aktet e tilla të cilat janë të nxjerrura nga Qeveria , Ministri , Ministria apo Komuna.

- (u) “Liçensë” do të thotë një instrument ligjor zyrtar me shkrim i nxjerë nga një autoritet publik që autorizon mbajtësin që aty e tutje të angazhohet në një llojë të veçantë të biznesit apo aktivitetit tjetër vazhdues, në pajtim me kushtet e saktësuara në liçensë.
- (v) “Autorizim” do të thotë një instrument zyrtar me shkrim të nxjerë nga një autoritet publik që autorizon mbajtësin që aty e tutje të zbatojë aktivitetet apo projek jo më shumë se një herë, në pajtim me kushtet e përshkruara në atë autorizim.
- (w) “Person” do të thotë një person fizik apo juridik.
- (x) “Ndotës” do të thotë personat që shkaktojnë ndotje.
- (y) “Ndotje” do të thotë shkarkimin e një substance (duke përfshirë substanca në formë të ngurtë, lëgët apo në formë të gaztë) ose energji (duke përfshirë vibrimin, radiacionin, ngrohjen, dritën, zhurmën apo forma të tjera të energjisë) në mjedis, që ka potencial domethënës që t’i shkaktojë dëme shëndetit njerzor, organizmave të gjallë apo eko-sistemeve apo dëm mjedisor.
- (z) “Rajone të mbrojtura” janë rajone të përkufizuara në mënyrë të veçantë si rajone të mbrojtura nga ky ligj apo një akt plotësues normative i nxjerë në bazë të këtij ligji, më qëllim promovimin dhe ruajtje e disa tipareve të vlefshme natyrore që kanë rëndësi të vlefshme topografike, ekologjike apo rekreative.
- (aa) “Autoritet publik” do të thotë secilën nga vijueset:
 - (i) një autoritet ekzekutiv, organ publik, ministri, departament, agjension apo autoritet tjetër qendror apo rajonal, komunal apo lokal që ushtron pushtet ekzekutiv, legjislativ, rregullativ, publik-administrativ apo juridik në bazë të një akti normativ apo akti plotësues normativ.
- (bb) “Shërbimet publike në lëminë e mbrojtjes mjedisore” do të thotë ato shërbime publike që ofrohen nga operatorët e shërbimeve publike dhe që përfshin mbledhjen dhe menaxhimin e mbeturinave, furnizimin me ujë, shërbimet për mirmbajtjen ujrave e zeza dhe sigurimin e shërbimeve të tjera që në mënyrë të drejt-për-drejt janë të lidhura me parandalimin apo menaxhimin e ndotjes.
- (cc) “Ndërmarrje” do të thotë çdo partneritet, ndermarrje, person juridik, asociacion, projekt, filial, zyrë apo organizata dhe themelime të tjera.
- (dd) “Burim natyror me vlerë” do të thotë, fenomen i njohur natyror që është shumë i vlefshëm, i paktë dhe unik, dhe që është konsideruar si i tillë nga ky ligj apo akte normative të dala në pajtim me këtë ligj; një burim i tillë natyror mund të përfshijë fenomen unik gjeografik siç janë fosilet, mineralet të pazakonshme, akumulime apo formacione, shpella, gërxhe, ujvara, liqene, lumenj, fusha me ujë, bimë dhe kafshë unike, si dhe ekosisteme dhe pejsazheve.
- (ee) “PSSP” do të thotë Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përhershëm i Kombeve të Bashkuara dhe zyreve nën jurisdikcionin e tij/saj.

- (ff) “UNMIK” do të thotë Administrata e Përkohshme e Kombeve të Bashkuara në Kosovë.
- (gg) “Riciklim” do të thotë mbledhja selektive e mbeturinave komunale me qëllim të riprodhimit dhe ripërdorimit. Materiali i njejtë përdoret për të prodhuar një produkt të njejtë ose të ngjashëm me të përparshmen.
- (hh) “Organizma të Modifikuar Gjenetikisht” janë organizmat (bimët, shtazët, mikroorganizmat dhe pjesët e tyre) të krijuara nëpërmjet inxhinjeringut gjenetik respektivisht modifikimeve gjenetike.

Neni 3

Organet përgjegjëse për administrimin e mbrojtjes së mjedisit

1 Autoritetet publike do të marrin pjesë në aktivitetet e mbrojtjes së mjedisit deri në masën që në mënyrë specifike u kërkohet apo janë të autorizuar edhe të detyruar nga ky ligj apo akte normative të nxjera në bazë të këtij ligji.

2 Kuvendi dhe Qeveria e Kosovës, sigurojnë mbrojtjen e mjedisit përmes nxjerrjes së dokumenteve strategjike dhe programeve për mbrojtjen e mjedisit nga fusha të veqanta, me kusht që dokumente të tilla strategjike dhe programe do të jenë konform me dispozitat e tjera të këtij ligji.

3 Ministria do të bëjë mbrojtjen e mjedisit deri në pikën që specifikisht është e autorizuar me këtë ligj, dispozitat të akteve normative plotësuese të nxjera me këtë ligj brënda përmbydhjes së përgjegjësive që janë specifikuar në Rregulloren e UNMIK-ut 2001/19 ashtu siç është ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2002/5.

4 Komuna mund, deri në masën që specifikisht kërkohet apo autorizohet me këtë ligj apo dispozitat të akteve normative plotësuese të nxjera në pajtim me këtë ligj, ushtrojë përgjegjësi për ato çështje mjedisore që dalin apo ka mundësi të dalin në atë komunë, në rast se ato çështje mund të merren përsipër, kontrollohen, paranalohen, financohen ose menaxhohen nga ajo komunë vetë. Çështjet mjedisore që bëjnë pjesë brënda përgjegjësive të një komune janë:

- (a) krijimi i standardeve, në pajtim me këtë ligj dhe akteve normative plotësuese të nxjera në pajtim me këtë ligj, për operatorët lokal, që nuk janë nën menaxhimin apo administrimin e PSSP-së, të shërbimeve publike në fushën e mbrojtjes së mjedisit;
- (b) të sigurohet konformiteti i operatorëve me standarde të tilla;
- (c) planifikimi që ka të bëjë me mbrojtjen e mjedisit brënda një komune të tillë;
- (d) krijimi i masave të arsyeshme locale për mbrojtjen e mjedisit në mënyrë që të jenë në pajtim me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, në pajtim me këtë ligj dhe aktet normative plotësuese të nxjera në pajtim me këtë ligj;
- (e) krijimi dhe fuqizimi i masave që kanë për qëllim të kontrollojnë nivelin e zhurmës në një komunë të tillë;
- (f) çështje të tjera mjedisore që u janë detyruar komunave me këtë ligj apo me aktet normative plotësuese të nxjera në pajtim me këtë ligj.

5 Ministria do të ushtrojë mbikqyrjen administrative dhe analitike të aktiviteteve për mbrojtjen e mjedisit nëpër komuna, më qëllim që të sigurojë (i) konformitetin e komunave me dispozitat e këtij ligji apo aktet normative plotësuese të nxjera me këtë ligj; dhe (ii) koordinimin e aktiviteteve të Ministrisë me ato të komunave për mbrojtjen e mjedisit brënda dispozitave të këtij ligji dhe akteve normative plotësuese të nxjera në pajtim me këtë ligj. Me qëllim që të arihet një konformitet dhe koordinim i tillë, Ministria do të ketë kompetenca që të kërkojë nga komunat të ndryshojnë, anulojnë, ose krijojnë masa apo standarde mjedisore.

6 Aktivitetet që kanë për qëllim nxitjen e përdorimit racional të burimeve natyrore, adoptimin e ushtrimeve të sigurta mjedisore dhe promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, mund të bëhen me instruksione administrative, persona, organizata joqeveritare, organizata profesionale dhe ndermarrje.

Neni 4

Objektivat e mbrojtjes së mjedisit

Objektivat themelore të mbrojtjes të mjedisit janë aritja e qëllimeve të përgjithshme në vijim, me qëllim që të jenë edhe reale edhe të përballueshme nga autoritetet publike, personat dhe ndermarrjet, dhe të jenë konform me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik në Kosovë:

- (a) zvogëlimi gradual i ndotjes, degradimit dhe dëmit mjedisor si dhe minimizimi ose ndalimi i atyre aspekteve ekonomike dhe aktiviteteve të tjera që përbëjnë një rezik të madh për shëndetin e njeriut dhe mjedisit;
- (b) mbrojtja e biodiversitetit dhe balanc i përgjithshëm ekologjik në Kosovë;
- (c) shfrytëzimi racional dhe i qëndrueshëm i burimeve natyrore dhe tokës prodhuese si dhe mbrojtja e akumulimeve gjenetike të natyrës;
- (d) mbrojtja e pamjeve të vlefshme natyrore; dhe
- (e) ruajtjen dhe rehabilitim e diversitetit, vlerave kulturore dhe estetike të pejsazhit.

Neni 5

Parimet udhëzuese të politikës për Mbrojtjen e mjedisit

1. Deri në masën që një autoriteti publik i është kërkuar ose është autorizuar nga një dispozitë e këtij ligji apo akti normative plotësues të nxjerë në pajtim me këtë ligj, të implemetojë apo adoptojë këtë ligj dhe/ose të implemetojë akte normative plotësuese të nxjera në pajtim me këtë ligj, do t'i ushtrojë detyrat në bazë të parimeve udhëzuese të politikës në vijim, por megjithatë që marin në konsiderim një evaluim real të (i) mundësive të autoriteteve publike, personave apo ndermarrjeve në Kosovë për të përballuar masën e mbrojtjes të propozuar të mjedisit, dhe (ii) ndërhyrjes së mundshme negative të qëllimit për promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik në Kosovë:

(a) Parimet e harmonizimit gradual me standardet e Bashkimit Europian

Mbrojtja e mjedisit do të bazohet në sjelljen graduale të standardeve të Bashkimit Europian me qëllim krijimin e detyrueshëm të një mjedisi të shëndoshë për individët me principet e ushtrimit të një praktike sa më adekuate, të adoptuar brënda komunitetit shkencor, për përmirsimin e mjedisit.

(b) Balancimi i mbrojtjes të mjedisit dhe nevojës për zhvillim ekonomik

Të gjitha masat për mbrojtjen e mjedisit, standardet dhe aktivitetet do të projektohen dhe implementohen në mënyrë që të: (i) balancohen objektivat e mbrojtjes të mjedisit me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe (ii) zvogëlohen shpenzimet në nivel të arsyeshëm që të mund të përballohen nga Qeveria dhe populli i Kosovës.

(c) Parimi i ruajtjes së rajoneve të mbrojtura dhe burimeve natyrore me vlerë

Individëdëve, ndermarrjeve dhe autoriteteteve publike do tu kërkohet të ndalojnë aktivitetet që pa-arsyeshmëri rezikojnë biodiversitetin e Kosovës, pejsazheve edhe rajoneve nën mbrojtje.

(d) Parimi i integritimit graduar të mbrojtjes të mjedisit

Autoritetet publike do të bashkuponjnë dhe koordinojnë njëra me tjetrën për zhvillimin, adoptimin e çdo mase, standardi apo aktiviteti që ka për qëllim mbrojtjen e mjedisit.

(e) Parimi i vigjilencës dhe parandalimit

Deri në pikën e veprimit të arsyeshëm, duke konsideruar shpenzimet dhe beneficionet e pritura mjedisore, një aktivitet do të planifikohet dhe implementohet në atë mënyrë që të parandalojë ose të ndërpresë efektet shkatëruese në mjedis dhe rezikimin e mundshëm për shëndetin e njeriut.

(f) Parimi i ripërdorimit, riciklimit, si dhe supstituimit të kemikaleve

Autoritetet publike do të inkurajojnë përdorimin e substancave që mund të ripërdoren, ripërpunohen ose biologjikisht shkatërohen dhe përdorimin e kemikaleve dhe mjeteve të tjera që janë më pak të dëmshme për mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

(g) Parimi – ndotësi paguan dhe shfrytëzuesi paguan

Një person, ndërmarrje apo autoritet publik që ka shkaktuar një dëm të madh apo kritik mjedisor, do të jetë përgjegjës për kompezimin e kostos për zvogëlimin apo minimizimin e një dëmi të tillë. Personi, ndërmarrja apo autoriteti i tillë do të jetë gjithashtu përgjegjës për kompezimin e çdo dëmi që e kanë vuajtur të tjerët si rezultat i një dëmi të madh apo kritik mjedisor.

(h) Parimi i përgjegjesisë të pronarit trashëgimtar juridik i pronës

Nëse një copë pronë ka përqëndrim të ndotjes ose mbeturinave të dëmshme që krijojnë dëm tepër të madh dhe kritik mjedisor, pronari i një prone të tillë do të jetë përgjithsisht përgjegjës për zvogëlimin apo minimizimin brenda një kohe të arsyeshme e një përqëndrimi të tillë, në rast se përqëndrimi i tillë realisht i kanoset shëndetit të njeriut apo mjedisit, pronari nuk do të mbajë përgjegjësi për zvogëlimin apo minimizimin e përqëndrimit të tillë, në rast se ky është rezultat i një ndërmarrje shoqërore apo publike.

Një pronar nuk do të jetë përgjegjës të zvogëlojë apo minimizojë përqëndrimet e tilla që ekzistojnë përpara datës efektive të këtij ligji në rast se pronari nuk ka marrë pjesë në asnjë mënyrë në aktet që kanë rezultuar në një përqëndrim të tillë. Mundësohet, deri në atë pikë që pronari ta ketë blerë pronën me një çmim të ultë për shkak të prezencës të përqëndrimit të tillë, atëherë pronari do të detyrohet të paguajë koston për zvogëlimin dhe minimizimin e përqëndrimit deri në dallimin e vlerës së pronës në treg gjatë kohës së blerjes dhe uljes së çmimit të paguar nga pronari.

(i) Parimi i sigurimit të detyruar

Një person që merret me aktivitet që mundësojnë një rezik jashtzakonisht të madh për personin/at e tretë dhe/ose dëmin në mjedis do t'i kërkohej të ketë disa baza të sigurimit për të mbuluar përgjegjësinë e mundshme kundrejt personit/ave të tretë në rast të aksidentit mjedisor.

(j) Parimi i përgjegjesisë subsidare

Në rastet kur përgjegjësia nuk mund që në mënyrë të arsyeshme ose ligjore t'ja imponojë specifikisht një personi, ndërmarrjeje, grup personash apo ndërmarrjesh, përgjithsisht do të jetë përgjegjëse Qeveria për përballimin e kosotove, në pajtim me mundësitë financiare, që do dalin nga zvogëlimi apo minimizimi i përqëndrimit të ndotjes dhe mbeturinave të dëmshme që krijojnë një dëm tepër të madh ose kritik për mjedisin ose riparimin e dëmit mjedisor.

(k) Parimi i masave inkurajuese

Qeveria do të promovojë aktivitetet që kanë për qëllim parandalimin dhe zvogëlimin e ndotjes me zhvillimin e projekteve, për shqyrtim nga Kuvendi, për krijimin e masave që kanë për qëllim inkurajimin dhe ngritjen e iniciativave për sjelljen e ushtrimeve, aktiviteteve dhe/ose teknologjive. Të gjitha projektet e tilla do të përfshinë detajisht kosotot/beneficionet e vlerësimit të secilës nga masat.

(l) Parimi i mbrojtjes së të drejtave në gjykatë

Cdo person apo ndërmarrje ose grup personash apo ndërmarrjesh, në rast se vuajnë dëme materiale ose janë përpara një riziku të vuajnë dëme materiale që kanë të bëjnë me një aktivitet të veçantë ose burim të ndotjes që bën shkeljen e këtij ligji apo akteve normative plotësuese të nxjerra në pajtim me këtë ligj, do të kenë të drejtën të ngrenë padi ose të kërkojnë nga gjykata kompetente

ose autoritetet publike fuqizimin adekuat të ketij ligji apo akteve plotësuesë normative të dala nga ky ligj.

(m) Parimi i aksesit publik në informata

Të gjithë personat kanë në përgjithësi të drejtë të jenë të informuar për gjendjen e mjedisit. Informata që kanë të bëjnë me gjendjen e mjedisit dhe informata të tjera të lidhura me mjedisin për procedurat dhe aktivitetet e autoriteteve publike dhe shërbimeve vepruese të autoriteteve publike që bëjnë shërbimet publike në fushën e mbrojtjes të mjedisit do të, deri në masën e kërkuar me Ligjin për Lirinë e Informatave që do të mundësojnë informacionin publik dhe do t'i ofrojnë publikut akses në informata.

KAPITULLI II.
DOKUMENTET PËR MBROJTJËN E MJEDISIT

Neni 6

Strategjia e Kosovës për mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të mjedisit

1. Qeveria do të hartojë dhe do t'i parashtrojë Kuvendit një projekt për Strategjinë e mbrojtjes të mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të Kosovës.
2. Projekti për strategjinë e mbrojtjes të mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm ekonomi për Kosovën do të përmbajë qëllime dhe udhëzime për mbrojtjen e mjedisit të Kosovës për një periudhë kohore dhjetë vjeçare dhe do të koordinohet me planin hapsinor të Kosovës.
3. Projekti për strategjinë e mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik do të përfshijë, së paku:
 - (a) Propozim politika për përdorimin e burimeve natyror;
 - (b) Analiza të kërkimeve shkencore të gjendjes të tanishme të burimeve natyrore, lokacionin hapsinor, kuantitetin dhe kualitetin e burimeve natyrore të Kosovës;
 - (c) Propozim i piroriteteve strategjike për përdorimin e burimeve natyrore, përfshirë kohën dhe lokacionin hapsinor, kuantiteti, kualiteti, renovimi dhe rezervat strategjike;
 - (d) Propozim kushtet për zëvendësimin gradual, aty ku është mundësia, të burimeve të varfëruara natyrore;
 - (e) Gjendja e biodiversitetit në Kosovë dhe rajoneve të mbrojtjes të natyrës;
 - (f) Një analizë e gjendjes të mjedisit, indentifikimi i dëmeve të mëdha mjedisore dhe efekti i tyre në shëndetin publik;
 - (g) Propozim bazë i elementeve dhe kushteve për mbrojtjen e mjedisit dhe përmirsimin e mjedisit;
 - (h) Parashikim i gjatë kohor për trendet dhe kushtet mjedisore;

- (i) Propozimi i qëllimeve dhe metodave reale për ballafaqimin me trendet dhe kushtet mjedisore;
- (j) Një evaluim real i mjeteve financiare të nevojshme për aritjen e qëllimeve dhe propozimi i burimeve të mjeteve të tilla; dhe,
- (k) Propozim i prioriteteve të detyrave dhe projekteve si dhe autoritetet që propozohen t'i marin përsipër përgjegjësitë për implementimin e tyre.

4. Propozim strategjia për mbrojtjen mjedisore të Kosovës dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik do të përgatiten nga Ministria në koordinim me Ministri të tjera dhe institucione shkencore të Kosovës.

5. Përpara se strategjia për mbrojtjen mjedisore të Kosovës dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik i propozohet Kuvendit për miratim, do t'i bëhet e njohur publikut nëpërmes mediave për të paktën dyzetepesë (45) ditë me qëllim t'i lejohet publikut të shprehim mendimet e tyre, sugjerimet, komentet dhe opinionet.

Neni 7

Programet e mbrojtjës së mjedisit

1. Çdo pesë vjet, Ministria do t'i parshtrojë Qeverisë një propozim program për mbrojen e mjedisit në Kosovë. Propozim programi do të përfshijë propozime për masa që duhen ndërmarrë ose standarde për krijim e ardhshëm siç vijon:
 - (a) Promovimi i një sistemi integral për mbrojtjen e mjedisit dhe promovimin e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm;
 - (b) Përmirsimet në planifikimin mjedisor dhe rregullimi;
 - (c) mbrojtja e ujit;
 - (d) mbrojtja e tokës;
 - (e) mbrojtja e ajrit dhe atmosferës (përfshirë ozonin);
 - (f) mbrojtja e biodiversitetit, ekosistemeve dhe rajoneve natyrore nën mbrojtje;
 - (g) rregullimi i aktiviteteve që përfshinë mbeturinat e rezikshme dhe kemikale degjeneruese; dhe
 - (h) mbrojtja nga zhurma dhe vibracioni.
2. Të gjitha propozimet e përfshira në propozim programin do të përmbajnë evaluimin e detaktuar të kostove/benificionit të të gjitha masave dhe standardeve të propozuara.
3. Komunitat mund të adoptojnë programe komunale për mbrojtjen e mjedisit dhe programe pune të ngjashme. Këto programe do të jenë konform me këtë ligj dhe aktet plotësuese normative të miratuara në bazë të këtij ligji.

Neni 8

Aktet e Planifikimit dhe rregullimit Hapësinor

1 Plani hapësinor i Kosovës, Plani hapësinor i komunave, planet për menaxhimin e resurseve natyrore dhe planet e programet e zhvillimit të përcaktuara me ligj, të cilat kanë ndikim në mjedis duhet patjetër të përfshijnë vlerësim të aktiviteteve të planifikuara dhe ndikimin e tyre mbi mjedisin. Vlerësimi i aktiviteteve të planifikuara dhe ndikimi i tyre në mjedis përgatitet dhe paraqitet në mënyrën dhe procedurën e parapar me ligj dhe evaluimin e ndikimeve pozitive ekonomike të mundshme në aktivitetet e tilla.

2 Planifikimi hapësinor dhe logjistik-urban do të:

- (a) përshkruaj një regjim special për mbrojtjen e natyrës, rajoneve nën mbrojtje, ujit, tokës, hapsirave të gjelbërta publike, zonave rekreative dhe banjove natyrore;
- (b) definojë rezikun mjedisor të rajoneve (rajone të ndotura, rajone të rezikuara nga erozioni, nga hedhja e materialeve të papërpunuara, etj.) dhe definojë përpunim masat për rehabilitimin e rajoneve të tilla;
- (c) propozojë masat dhe kushtet për mbrojtjen e mjedisit për hapësirat të dedikuara për përdorimin e burimeve natyrore, ndërtimit të fabrikave për prodhimin e energjisë, fabrika industriale dhe infrastruktura dhe ndërtimi i strukturave për përqëndrimin e mbeturinave.

3 Vlerësimi i aktiviteteve të planifikuara përfshinë analizimin e gjendjes aktuale të mjedisit, ndikimit të mundshëm në mjedis të aktiviteteve të planifikuara, veprimet e propozuara për zbutjen e tij si dhe zhvillimin ekonomik.

4 Plani hapësinor i Kosovës, Planet hapësinore rajonale, Planet hapësinore komunale si dhe aktet e tjera të planifikimit dhe rregullimit hapësinor, para aprovimit të tyre, i paraqiten për vlerësim (dhënje të mendimit profesional) Agjencionit të Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit, që është nën autoritetin e Ministrisë.

Neni 9

Raporti për gjendjen e mjedisit

1 Qeveria e Kosovës, në propozim të Ministrisë, i paraqet Kuvendit të Kosovës raport dyvjeçar për gjendjen e mjedisit. Raporti përfshin, veç të tjerash, të dhëna mbi:

- (a) gjendjen e tanishme të mjedisit dhe ndryshimet në mjedis;
- (b) ndikimet mjedisore në shëndetin e publikut;
- (c) dëmet mjedisore;
- (d) qëndrueshmërinë e përdorimeve të burimeve natyrore;
- (e) implementimin e programit për mbrojtjen e mjedisit në Kosovë dhe programet e punës, si dhe efekti i tyre në zhvillimin ekonomik;
- (f) marjen e masave për mbrojtjen e natyrës, sukseset nga masat e mara dhe efekti i tyre në zhvillimin ekonomik;

- (g) analizat për funksionimin e Ministrisë dhe autoriteteve dhe veprimtaritë e operatorëve të shërbimeve publike që ofrojnë shërbime publike”
 - (h) evaluimin e shpenzimeve të kaluarës, të tashmes dhe ardhshme për ndikimin ekonomik në aktivitetet mjedisore të bëra nga Ministria.
2. Raporti do të publikohet dhe do të jetë i hapur për publikun.

KAPITULLI III: **MASAT PËR MBROJTJEN E MJEDISIT**

PJESA 1: Standartet dhe rregullat

Neni 10

Nivelet e shkarkimit dhe shpërndarjes

1. Qeveria, me propozimin të Ministrit, do të ketë autoritet të nxjerë akte plotësuese normative që krijojnë nivelin e pranueshëm për shkarkim dhe shpërndarjes të materieve ndotëse përfshirë materialet ndotëse të ngurta, të lëngta dhe të gazta dhe substanca të rezikshme në ajër, ujë, dhe tokë.
2. Të gjitha aktet normative plotësuese, të autorizuar nga ky nen, do të zhvillohen, adoptohen dhe ndryshohen kohë-pas-kohe që të mund gradualisht të përputhen me standardet dhe kushtet relevante të BE-së në mënyrë që është edhe realisht e përballueshme nga autoritetet publike, personat dhe ndermarrjet si dhe është konform me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik në Kosovë.
3. Një nga aktet normative plotësuese e autorizuar nga ky nen do të krijojë nivele të pranueshme për shkarkim nga makinat që përmbajnë makineri të mbrëndshme djegëse.
4. Ku mendohet të jetë në interes të publikut të veprohet ashtu, Qeveria do të suspendojë, plotësisht apo pjesërisht, aplikimin e një akti plotësues normativ të autorizuar nga ky nen kundrejt një ndotësi ekzistues, në rast se ndotësi ekzistues hyn në kontratë administrative me Qeverinë që kërkohet nga ndotësi ekzistues të përmbushë standartet më strikte të shkarkimit gjatë një kohe, në pajtim me afat kohor specifik progresiv. Çdo kontratë e tillë do t'i kërkojë ndotësit përkatës ekzistues të paguaj në baza të regullta një taksë të arsyeshme, që do të bëhet pjesë e Fondit të Konsoliduar të Kosovës. Çdo kontratë e tillë do t'i parashtrahet Kuvendit për shqyrtim, dhe asnjë kontratë e tillë nuk do të bëhet efektive nëse dhe vetëm atëher kur ratifikohet nga Kuvendi.
5. Ku mendohet që është në interes të publikut të veprohet ashtu, Qeveria mund të hyjë në kontratë administrative me ndotësin ekzistues me kërkesë që ndotësi i tillë të pajtohet me standardet më strikte për shkarkim se sa ato të nxjerra më aktet plotësuese normative të nxjerra në pajtim me këtë nen. Me qëllim që të mundësohet inkurajimi i ndotësve të tillë ekzistues të hynë në një kontratë administrative të tillë, Qeveria do të bëjë propozime, për shqyrtim nga Kuvendi, duke i rekomaduar Kuvendit që të krijojë disa standarde inkurajuese

që Qeveria të mund t'ja ofrojë ndotësve ekzistues. Çdo kontratë e tillë që inkurajon ndotësit ekzistues do t'i parashtrohet Kuvendit për shqyrtim, dhe asnjë kontratë nuk do të jetë efektive nëse dhe vetëm atëher kur ratifikohet nga Kuvendi.

Neni 11

Rregullat e veprimit

Qeveria, me propozimin nga Ministria, do të ketë kompetenca nxjerë një apo më shumë akte normative plotësuese duke specifikuar bazat e rregullave për veprim që do të jenë të mbikqyrura nga operatorët e shërbimeve publike në fushën e mbrojtjes të mjedisit.

Neni 12

Rregullat e veprimit me mbeturina dhe materie të rrezikshme

1. Qeveria, pasi mer propozimin nga Ministri, do të ketë kompetenca të nxjerë një apo më shumë akte plotësuese normative që specifikon rregullat e veprimit që duhet të observohen nga një autoritet publik, person ose ndërmarrje që marin pjesë në biznesin e menaxhimit, përqëndrimin, transportin dhe administrimin të mbeturinave dhe mbeturinavë të dëmshme. Aktet plotësuese normative të tilla mund të specifikojnë kërkesat teknike dhe/ose kritere që i aplikohen:

- (a) vendndodhja ose krijimi i një strukture për mbajtjen apo hudhjen e mbeturinave dhe mbeturinave të dëmshme;
- (b) koleksionimi, klasifikimi, vendosja dhe transportimi i mbeturinave dhe mbeturinave të dëmshme;
- (c) ripërpunimin, shfrytëzimi, dhe metoda të tjera të ripërdorimit të mbeturinave;
- (d) mbledhja, shaktërimi dhe/ose trajtimi i mbeturinave dhe mbeturinave të dëmshme; dhe
- (e) përdorimi i mbeturinave si material për prodhimin e energjisë, materialeve të papërpunuara, etj.

2. Në rast se Qeveria mendon që është në interesin e publikut të sigurojë që vetëm një person apo ndërmarrje që mban licensë të veçantë mund të meret me trajtimin e veçantë të mbeturinave dhe mbeturinave të rrezikshme, Qeveria mund të zhvillojë dhe nxjerë akt plotësues normativ, të thjeshtë, racional, jodiskriminues dhe jo-ekskluziv ku përfshihen kushtet për licencë që duhen plotësuar nga një person apo ndërmarrje për të marë licencën e tillë. Një licencë e tillë mund të përshkruaj kushtet rationale dhe jodiskriminuese që duhet të përmbahen nga mbajtësi i licencës. Licensa e tillë do t'i lëshohet çdo aplikanti që përmbush kushtet.

3 Qeveria do të ketë autoritet të nxjerë akte plotësuese normative, që kërkojnë nga të gjitha autoritetet publike, personat dhe ndërmarrjet të mbajnë të dhënat reth trajtimit/aktiviteteve të mbeturinave dhe materieve të dëmshme.

Neni 13**Miratimi dhe ndalimi për importet**

1 Në territorin e Kosovës është i ndaluar importimi, përpunimi, ose grumbullimi i materieve radioaktive dhe mbeturinave të tjera të rrezikshme me prejardhje jashtë kufinjëve të Kosovës, përveç kur lejohet nga Qeveria.

2 Qeveria, në pajtim me Ligjin për tregëtinë e jashtme, me akt të veçantë përcakton:

- (a) rastet në të cilat inspektimi mjedisor i mallrave që importohen përkohësisht apo vazhdimisht, është i detyrueshëm;
- (b) rastet në të cilat ndalohet importi, eksporti, magazinimi dhe kalimi tranzit i përhershëm ose i përkohshëm i mallrave të caktuara, nëpër territorin e Kosovës dhe
- (c) rastet në të cilat është i nevojshëm miratimi paraprak i Ministrit për importimin, eksportimin, magazinimin apo kalimin tranzit të mallrave.

3 Ministri përcakton mënyrën sipas të cilës bëhet inspektimi mjedisor i mallrave të importuara përkohësisht ose vazhdimisht.

4 Ministria mund të vendosë asgjësimin e mallrave ilegalisht të importuara, eksportuara, magazinuara dhe që kalojnë tranzit në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

Neni 14**Lajmërimet e popullsisë**

1 Ministri për mjedis, së bashku me Ministrin për shëndetësi, nxjerr paralajmërimet, rekomandime dhe masa mbrojtëse kur ndotjet tejkalojnë nivelet kritike të vlerave të kufizuara të parapara me nenin 10 të këtij ligji.

2 Komunitet nxjerrin aktin për paralajmërimet, rekomandime dhe masa mbrojtëse në rastet e ndotjes me karakter lokal.

3 Nëse vlerësimi i ndikimit ambiental tregon se veprimtaria e synuar mund të sjellë rrezik për çrregullim mjedisor, leja për projekte apo veprimtari tjera përcakton detyrimin e Ministrit për të paralajmëruar, udhëzuar dhe këshilluar popullatën.

Neni 15**Paralajmërimet për prodhuesit**

1. Qeveria, në propozim nga Ministri, do të krijojë listën me artikujt që kanë nevojë për etiketën paralajmëruese mjedisore dhe sqarime për përmbajtjen e etiketës paralajmëruese mjedisore.

2. Vetëm prodhuesit, shitësit e mallrave me të madhe apo importuesit, që meren me kuantitete komerciale të sendeve që kanë nevojë për etiketim, do të jenë përgjegjës për të respektuar kërkesat e etiketimit.
3. As lista dhe as kërkesat e etiketimit të përmendura më sipër, nuk do të tejkalojnë normat ose nuk do të jenë më të rënda se kërkesat relevante të BE-së.
4. Me qëllim që të krijohet konformitet me kërkesa të tilla etiketimi, Qeveria do të krijojë gjopa monetare të arsyeshme për shkeljen e atyre kërkesave; megjithatë, duke marrë parasysh që gjatë dymbëdhjetë (12) muajve të parë të parë pas krijimit të kërkesave të tilla etiketimi, Qeveria nuk do të aktivizojë dënimet e tilla dhe do t'i paralajmërojë ata që bëjnë shkejen e këtyre kërkesave dhe do t'i informojë ata mbi kërkesat e etiketimit dhe masat potenciale që mund të meren kundër atyre që nuk respektojnë këto kërkesa.

Neni 16

Detyrimi për njoftim dhe bashkëpunim

- 1 Kushdo që ka dijeni, ose mund të ketë dijeni, për dëmtim të mjedisit ose aksident ekologjik duhet të njoftojë Inspektoriatin ose organin tjetër përgjegjës. Institucionet publike do të bashkëpunojnë me inspektoratin mjedisor, meqë është arsyeshmërisht e nevojshme, në kërkim të arsyes për një dëm specifik mjedisor ose dëm të madh apo kritik mjedisor.
- 2 Policia dhe zyrtarët e tjerë publik të autorizuar, të cilët, gjatë kohës së kryerjes së detyrës së tyre zyrtare vijnë në dijeni lidhur me akcidente ekologjike ose çrregullim tjetër mjedisor, duhet të njoftojnë menjëherë Inspektoriatin
- 3 Institucionet administrative shkencore të Kosovës dhe të komunave duhet të bashkëpunojnë dhe t'a ndihmojnë Inspektoriatin Mjedisor në gjetjen e shkaqeve të çrregullimeve mjedisore dhe identitetit të përgjegjësit për çrregullimin.

PJESA 2 : Detyrimet materiale të palëve përgjegjëse

Neni 17

Përgjegjësia dhe detyrimet për çrregullim të madh ose kritik mjedisor

1. Qeveria do të ketë autoritet të nxjerr akte normative plotësuese që imponojnë gjopa të arsyeshme për persona, ndërmarrje dhe autoritete publike që marrin pjesë në aktivitete të cilat bëjnë çrregullime tepër të mbëdha ose kritike për mjedisin. Këto gjopa duhet të jenë në atë nivel që t'i diskurajojnë autoritetet e tilla, personat apo ndërmarrjet që të marrin pjesë në aktivitetet të tilla vazhduese. Në rastet ku mendohet e arsyeshme, ku është bërë çrregullim tepër i madh dhe kritik i mjedisit, aktet plotësuese normative të tilla mund të kërkojnë nga pala përgjegjëse të ndërmarrë ose paguaj për pastrimin e nevojshëm për të zvogëluar dëmin në nivel më të ulët se kritik.

2. Në rast se një copë prone ka përqëndrim të ndotjes apo mbeturinave të rezikshme që krijojnë çrregullim tepër të madh ose kritik mjedisor, pronari i një prone të tillë do të, në rast se vërtetohet se një përqëndrim i tillë ka me të vërtetë dëm për shëndetin e njeriut apo ambientit, jetë përgjithësisht përgjegjës për zvogëlimin dhe minimizimin, brënda një kohe të caktuar, përqëndrimin e tillë; duke patur parasysh, që në rast se përqëndrimi i tillë është rezultat i aktiviteteve të ndonjë ndermarjeje shoqërorë apo publike, pronari nuk do të jetë përgjegjës.

3. Një pronar nuk do të mbajë përgjegjësi për të zvogëluar apo minimizuar përqëndrimin, në rast se përqëndrimi i tillë ka qënë aty përpara datës efektive të këtij ligji, dhe në rast se pronari nuk ka ndihmuar apo ka marë pjesë në akte që kanë rezultuar në një përqëndrim të tillë. Megjithatë, nëse pronari e ka blerë pronën me çmim të ulët për shkak të prezencës të përqëndrimeve, atëher pronari do të jetë përgjegjës të paguaj për zvogëlimin dhe minimizimin e një përqëndrimi të tillë, deri në diferencën e çmimit në treg në kohën e blerjes dhe çmimit të ultë të paguar nga pronari.

4 Një person apo ndermarrje që marrin pjesë në aktivitete që përfshijnë një rezik të trashëguar dhe jashtzakonisht të madh për palën/ët e tretë dhe/ose dëm mjedisor do t'i kërkohet një sigurim bazë për të mbuluar përgjegjësinë e mundshme kundrejt palës të tretë apo aksidentit mjedisor. Qeveria do të nxjerë akte plotësuese normative që specifikon llojet e aktiviteteve që kërkojnë sigurim të domosdoshëm dhe nivelin e sigurimit të domosdoshëm që i aplikohet çdo lloji të aktivitetit.

Neni 18

Shfrytëzimi i resurseve natyrore

1 Personat juridikë ose fizikë mund të kryejnë aktivitete në hulumtimin, zbulimin, dhe shfrytëzimin e burimeve natyrore sipas kushteve në vijim:

- (a) t'i nënshtrohen procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis, nëse veprimtaria është objekt vlerësimi e ndikimit në mjedis në pajtim me nenin 20 të ligjit;
- (b) të respektojë të gjitha ligjet dhe rregullat në lidhje me aktivitetin e tyre;
- (c) nëse burimi natyror është pronë publike të ketë koncesion ose ndonjë të drejtë tjetër adekuate për përdorimin dhe shfrytëzimin e burimeve në përputhje me ligjin;
- (d) gjatë aktivitetit, të zvogëlojë çrregullimet mjedisore që rrjedhin prej tij, dhe
- (e) pas ndërprerjes së veprimtarisë të rehabilitojë ose rikthejë mjedisin në gjendjen e mëparshme në përputhje me projektin e rehabilitimit.
- (f) Për projekte, të cilat i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis, projekti i rehabilitimit duhet të përfshihet në raportin e ndikimit në mjedis.

2 Natyra e të drejtave në koncesione dhe procedura për dhënie e koncesioneve për përdorimin dhe shfrytëzimin e resurseve natyrore, përcaktohen me ligj.

PJESA 3: Masat e rehabilitimit

Neni 19

Masat e mbrojtjes dhe rehabilitimit

1. Kur mund të dëshmohet me dëshmi substanciale për neglizhencën, aktet e paramenduara, apo shkeljet nga ana e një personi, ndërmarrjeje apo autoriteti publik që sjall një dëm tepër të madh apo kritik mjedisor apo aksident mjedisor që rezulton në dëm mjedisor, një person, ndermarrje apo autoriteti i tillë publik do të detyrohet ta kthejë pjesën e dëmtuar në kondicionet që nuk paraqesin rezik për shëndetin publik apo kapaciteti të përgjithshëm regjenerues të pjesës së dëmtuar.

2. Aq më tepër, në rast se një person, ndermarrje ose autoritet i tillë publik mer pjesë në një aktivitet të vazhdueshëm që mund të sjellin dëm të madh apo kritik mjedisor ose aksident mjedisor që do të rezultojë në dëm mjedisor, një person, ndërmarrje apo autoritet i tillë publik do t'i këkohet të ndërmarë masa të arsyeshme që të sigurojë që aktivitetet e tilla në të ardhmen të bëhen në mënyrë që të (i) zvogëlohet shkarkimi dhe shpërndarja në nivelin e lejueshëm, dhe (ii) minimizim I rezikut për një aksident mjedisor, në pajtim me masat dhe praktikat e pranueshme ndërkombëtare.

3. Një person, ndermarrje apo autoritet publik që i kërkohet të ndërmarë masa sipas paragrafit 1 dhe/ose paragrafit 2, do të, në rastet komplekse ku shfaqet nevoja, jetë i detyruar të zhvillojë dhe parashtrijë Ministrin një plan me masat të nënvizuara që personi, ndërmarrja apo autoriteti publik ka për qëllim t'i ndermarrë. Ministri do të ketë në dispozicion gjashtëdhjetë (60) ditë për të shqyrtuar planin. Në rast se Ministri gjen baza të arsyeshme të besojë që masat e parapara nuk janë adekuate në bazë të paragrafit 1 dhe 2, Ministri brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve do ti japë personit, ndermarrjes apo autoritetit publik relevant, modifikimet e planit të kërkuara nga Ministri. Në rast se personi, ndërmarrja apo autoriteti relevant publik, mendon që modifikimet nga ana e Ministrin janë të panevojshme dhe tepër të shtrejta që nuk janë në përputhje me paragrafet 1 dhe/ose 2 personi, ndermarrja apo autoriteti publik relevant kanë të drejtën të sfidojnë, në gjyq, validitetin e një, disave apo të tëra modifikimeve.

4. Nëse identiteti i palës përgjegjëse për dëmin mjedisor nuk mund të gjehet, ose në rastet kur personi apo ndermarrja nuk ka fonde të mjaftueshme të rregullojë dëmin mjedisor, Qeveria do të ketë autoritetin – në rast se dëmi paraqet rezik të vazhdueshëm për shëndetin publik, adoptojë dhe implementojë një program të arsyeshëm për rregullimin e dëmit. Në rastet kur dëmi mjedisor është i natyrës lokale, atëherë Komuna do të ketë autoritetin të adoptojë dhe implementojë një program të tillë. Në rast se në cdo kohë në fillim apo gjatë programit të tillë, identiteti i palës zbulohet, Qeveria apo Komuna përkatëse do të mund të rimarrë shumën e shpenzuar për rregullimin e dëmit të bërë nga neglizhenca, akti me paramendim apo e shkelja e palës.

5 Para fillimit të zbatimit të programit të rehabilitimit , personi përgjegjes i paraqet Ministrin propozimin për miratimin e të njejtit.. Nëse Programi i rehabilitimit prekë edhe përgjegjësitë e Ministririve tjera, ato duhet t'i paraqesin mendimet dhe propozimet e tyre, para nxjerrjes së vendimit. Para dhënies së miratimit nga Ministri, propozimi i Programit të rehabilitimit, bëhet i disponueshëm për publikun për të paktën 14 ditë.

PJESA 4: Vlerësimi i ndikimit në mjedis, pëlqimi, leja dhe autorizimi mjedisor

Neni 20

Vlerësimi i ndikimit në mjedis

1. Një person, ndermarrje apo autoritet publik që planifikon të ndërtojë një objekt industrial, të përpunimit, punë të madhe apo projekt, do të, në qoftëse një projekt i tillë, ka potencial të bëjë dëm mjedisor, njëherë do të duhet të bëjë një vlersim të ndikimit në mjedis (VNM) dhe të njëjetën t'ja parashtojë Ministrisë me parafrazim të gjetjeve të VNM-së (raporti i VNM).
2. Një person, ndermarrje apo autoritet publik që planifikon të modifikojë operimin e një objekti industrial apo për përpunim do të, në rast se kjo paraqet një rezik potencial për të ritur apo zmadhuar shkarkimin ose shpërndarjes, njëherë duhet të bëjë VNM-në dhe pastaj ta parashtojë të njëjtën në Ministri raportin e parafrazuar të gjeturat e vlersimit.
3. Një VNM nuk do të kërkohet në rast të ndërtimit apo modifikimit të ndërtesave rezidenciale, komerciale jo-industriale brenda rajoneve të përshkruara për një ndërtim të tillë nga plani hapsinor në fuqi.
4. Qeveria, pasi që ka marë propozimin nga Ministria, do të nxjerë një akt plotëues normativ për të themeluar, në pajtim me nenin 21, një listë që specifikon (i) llojet e objekteve industriale për përpunim, projektet dhe punët për të cilat kërkohet VNM dhe raporti i VNM, dhe (ii) llojet e modifikimeve mbi objektet industriale për përpunim, projektet apo punë për përfundimin e të cilave kërkohet VNM dhe raporti i VNM.
5. Qeveria, në prpozim të Ministrit, do të nxjerr një akt plotësues normativ që specifikon, nivelin më të lartë të detajeve (i) përshkrimin e procedurave me të cilat do të bëhet një VNM, dhe (ii) përshkrimin e informative që do të përfshihen në një VNM raport. Një akt I tillë plotësues normativ mund të përfshijë procedura si dhe informata të ndryshme varësisht nga aktivitetet e ndryshme të planifikuara; megjithatë duke marë parasysh që ndryshimet e tilla do të kenë për bazë shkencën. Ndryshime të tilla mund të ketë edhe në bazë të madhësisë të aktiviteteve të planifikuara.
6. Një VNM dhe një raport i VNM mund të përgatitet dhe të parashtrohet vetëm nga një person, ndermarrje (i) që kanë ekspertiza dhe janë trajnuar në shkencat mjedisore, përgatitja e VNM, dhe përgatitjen e raportit të VNM (ii) janë mbajtës të liçensës (liçensë për VNM) nga Ministria që autorizon një person apo ndermarrje të tillë të bëjë një VNM si dhe të përgatitë nje raport të VNM. Qeveria, pasi që ka marë propozimin nga Ministri, do të nxjerë një akt plotësues normativ që specifikon kushtet minimume të arsueshme dhe jo-diskriminuese që një person apo ndermarrje duhet t'i plotësojë për të marë nje VNM liçensë. Një akt plotësues I tillë normativ do t'i kërkojë Ministrisë të nxjerë fakte për aritjen e kushteve të kërkuara, që janë krijuar me aktin plotësues normativ. Ministria nuk do të imponojë një limit numerik për lëshimin e liçensave për VNM. Akti plotësues normativ, gjithashtu do të kërkojë nga mbajtësit e liçensave përVNM që të bëjnë një VNM dhe të përgatitn një raport të VNM në mënyrë të pavarur dhe me objektivë shkencore. Ministria nuk do t'i lëshojë liçensë për VNM asnjë personi apo ndermarrjeje deri në momentin që akti i kërkuar plotësues normativ, nuk është nxjerë dhe të gjitha formularet për aplikim të jenë bërë gati, të adoptuara dhe të publikuara për publikun.

7. Ministria do të mirëmbajë dhe azhurojë një listë të të gjithë mbajtësve të liçensave për VNM. Ministria do t'ja mundësojë këtë listë menjëherë cilitdo person që e kërkon listën e të gjithë mbajtësve të liçensave për VNM. Megjithatë, as Ministria dhe asnjë tjetër organ apo nënpunës civil nuk do të ketë të drejtë të bëjë rekomandime për shërbimet e ofruara nga mbajtësit e liçensave për VNM.

Neni 21

Procedurat e vlerësimit të ndikimit në mjedis – pëlqimi mjedisor

1. Të gjithë zyrtarët publik dhe nënpunësit civil, që kanë kompetencat për të lëshuar leje ndërtimi, të gjithë personat apo ndërmarrjet që mbajnë një leje për të filluar aktivitetet e ndërtimit, do të jetnë të detyruar t'i nënshtrohen trajnimit bazik për VNM në bazë të kërkesave të parashtruara në nenin 20. si dhe aktet normative plotësuese të lëshuara në bazë të nenit 20 të këtij ligji
 2. Në rast se një zyrtar publik pranon një kërkesë për leje ndërtimi që parashikon një apo më shumë aktivitete që janë subjekte të VNM kushteve të parapara me nenin 20, zyrtari publik do ta njoftojë kërkuuesin se leja për ndërtim nuk mund të lëshohet deri në momentin që nuk është bërë VNM të jetë parashtruar raporti i kërkuar për VNM në Ministri, të jetë marë aprovimi mjedisor nga Ministria, dhe të gjitha këto t'i sillen zyrtarit publik. Zyrtari përkatës publik do ta njoftojë kërkuuesin e lejes që një VNM mund të bëhet dhe një raport të VNM mund të përgatitet vetëm nga, një mbajtës i liçensës për VNM të lëshuar nga Ministria.
 3. Pasi që është marë raporti për VNM, Ministria do të kërkojë menjëherë mendimin e AKMM për VNM raportin, dhe brënda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga dita që raporti i tillë është parashtruar, ose (i) do të lëshohet aprovimi mjedisor, ose (ii) do të refuzojë kërkesën me arsye të detajuara pse është bërë refuzimi. Ministria mund që me anë të refuzimit të propozojë modifikime, në rast se ekziston mundësia, ndërtimi I propozuar apo aktivitete të tjera që do t'i lejojnë Ministrisë të nxjerë një aprovim mbi propozimin.
 4. Në rast se një aplikant për aprovim mjedisor beson që refuzimi I kërkesës për aprovim mjedisor ka qënë arbitara dhe kaoriçios, I bërë me qëllime të caktuara, ose që nuk është bazuar në fakte shkencore apo standarde mjedisore në fuqi, aplikanti mund ta sifdojë vendimin në gjyq.
- 7 Para dhënies të pëlqimit mjedisor, Ministria përgjegjëse, përmes AKMM, me prezencën e aplikantit, siguron publikun, përmes mjeteve të informimit, për mundësinë e shqyrtimit dhe diskutimit publik të raportit të ndikimit mjedisor dhe të projekt vendimit për të paktën 15 ditë, por jo më shumë se 30 ditë , për të shprehur opinionin e tyre mbi propozimin e paraqitur. Vërejtjet dhe sygjerimet e opinionit publik duhet të respektohen por nuk janë të obliguara.
- 8 Ministria përgjegjëse për mjedis vendimin e saj mbi dhënien e pëlqimit mjedisor e shpallë në mediat publike brenda shtatë ditësh nga dhënia ose refuzimi i miratimit.

Neni 22

Procedura e lejës së veprimtarisë – lejës ekologjike

- 1 Lëshimi në punë i objektit të ndërtuar apo i stabilimenteve dhe pajisjeve që kanë qenë objekt i vlerësimit të ndikimit në mjedis, nuk mund të behët pa miratimin e lejës ekologjike nga Ministria.
2. Leja ekologjike miratohet për periudhën pesëvjeqare, në procedurën e aplikimit për pranim teknik të objektit dhe stabilimenteve ose pas kryerjës së punës provuese, por gjithësesi para miratimit të lejës për punë.
3. Ministri, me akt të veçantë , përcakton aktivitetet e nevojshme për miratimin e lejës ekologjike, formën e aplikimit , përmbajtjen e lejës ekologjike, revokimin e lejës, vazhdimin e vlefshmerisë si dhe regjistrin e lejeve të miratuara.

Neni 23

Autorizimi mjedisor

- 1 Pa paragjykuar nenet 20. dhe 21. të këtij ligji, askush nuk ka të drejtë të kryejë apo ndërmarrë ndonjë veprimtari që mund të shkaktojë çrregullim mjedisor nëse kjo veprimtari nuk ka marrë autorizim mjedisor nga Ministria.
- 2 Në afatin prej 6 /gjashtë/ muajve nga hyrja në fuqi të këtij ligji, Ministri përcakton një listë të veprimtarive që kërkojnë autorizim mjedisor, formën e aplikimit, procesin e aplikimit dhe përmbajtjen e autorizimit.
- 3 Autorizimi mjedisor nuk kërkohet për veprimtaritë për të cilat kryhet procedura e vlerësimit të ndikimit mjedisor .

Neni 24

Njoftimi i shteteve fqinje

Nëse një projekt i synuar mund të ndikojë direkt në mjedis përtej territorit të Kosovës, Ministri përgjegjës për mjedis, pas konsultimit me Qeverinë dhe PSSP-në, informon shtetet që ndikohen lidhur me mundësinë e dëmit nga projekti i synuar dhe u ofron atyre dokumentacionin e projektit të synuar përfshirë pa kufizim , raportin mbi ndikimin e projektit në mjedis, në pajtim me konventat ndërkombëtare, por pa u kufizuar vetëm ne to.

PJESA 5: Masat përkrahëse

Neni 25

Etiketa mjedisore

1 Prodhuesit të produktit të destinuar për konsum të përgjithshëm, në shenjë përkrahjeje, mund të akordohet, etiketa mjedisore, nëse prodhimi, tregtimi, konsumi dhe depozitimi përfundimtar i produktit shkakton ndjeshëm më pak çrregullim mjedisor.

2 Kushtet dhe procedurat për akordimin, fitimin, dhe të drejtën për përdorim të etiketës mjedisore, caktohen nga Ministri përgjegjës për mjedis .

Neni 26

Mirënjohjet dhe Shpërblimet

1 Mirënjohjet dhe Shpërblimet për arritjet në fushën e mbrojtjes së mjedisit jepen për:

- (a) zgjidhjet dhe arritjet teknologjike;
- (b) projektet hulumtuese dhe zhvillimore;
- (c) arritjet në fushën e vetëdijimit dhe ndërgjegjësimit mjedisor
- (d) kontributet nga organizatat, shoqatat profesionale, organizata të tjera jo-qeveritare për mbrojtjen e mjedisit dhe individët;
- (a) parandalimin e efekteve negative të çrregullimeve mjedisore,
- (b) prodhimin e produkteve ekologjike,
- (c) kontribute te veqanta në zhvillimin e qëndrueshëm, ekoefikasitet dhe racionalizime mjedisore.

2 Proçeduren, mënyrën dhe kushtet për ndarjen e mirënjohjeve dhe shpërblimeve, me akt të veçantë, e përcakton Ministri.

3 Ministria organizon dhe përkrah fushatat e ndërgjegjësimit dhe edukimit publik lidhur me rendësinë e mbrojtjes së mjedisit.

PJESA 6: Masat e veçanta për mbrojtjen e mjedisit

Neni 27

Planet e intervenimit në rast të akcidentit ekologjik

1 Për rastet e akcidenteve të mundshme ekologjike ose rastet e rrezikimeve të jashtëzakonshme të mjedisit, rrezikimit të shëndetit dhe jetës së njerëzve, Qeveria, në propozim të ministrive përgjegjëse nxjerr Planet e intervenimit.

- 2 Planet e intervenimit nga paragrafi 1. i këtij neni, përmbajnë:
- (a) llojet e rrezikshmërisë si pasojë e akcidentit ekologjik,

- (b) procedurat dhe masat për zbutjen dhe eliminimin e pasojave të drejtëpërdrejta të dëmshme për mjedis,
- (c) autoritetet publike për zbatimin e masave të caktuara ,
- (d) përgjegjësitë dhe autorizimet lidhur me zbatim të masave dhe
- (e) mënyren e harmonizimit me masat intervente të cilat zbatohen në bazë të ligjeve tjera

3 Ministri përgjegjës për mjedis, ka përgjegjësinë për nxjerrjen e në propozim plani që do të jetë objekt shqyrtimi dhe miratimi nga Qeveria, duke përfshirë këto në vijim:

- (a) Metodologjinë e hartimit të Analizës së rrezikut nga aksidenti ekologjik përkatësisht rrezikut nga ndotja e mjedisit, masat përgaditore për aksident të mundshëm ekologjik si dhe masat e evitimit të pasojave nga aksidentet me përmasa të mëdha;
- (b) Mënyren e mbajtjes së shenimeve për llojin dhe sasinë e materieve të rrezikshme në prodhim, shfrytëzim, qarkullim, transport, magazinim dhe deponim si dhe afatet për dergimin e shenimeve, dhe
- (c) Mënyren dhe kriteriumet për kategorizimin e materieve të rrezikshme.

4. Persona apo ndermarrje që marri pjesë në biznes, prodhim, transport, përdorim, përpunim dhe/ose deponimin e mbeturinave të rrezikshme apo substancave të rrezikshme do të jenë të detyruar të zhvillojnë dhe japin Ministrisë, çdo dy vjet, një document që përfshin:

- (a) planin e tyre për intervenim në rast të aksidentit mjedisor;
- (b) analizë të reziqeve të mundshme për aksident mjedisor;
- (c) përshkrimin e masave parandaluese dhe masat e planit të tyre rehabilitues në rast të aksidentit mjedisor; dhe
- (d) një histori të llojeve dhe shumave të substancave të rrezikshme në bazë të kategorisë të substancave të rrezikshme.

5 Nëse gjatë aksidentit ekologjik dhe rrethanave tjera të jashtzakonshme pason rreziku nga ndotja ose dëmtimi i mjedisit mematerje të rrezikshme dhe të dëmshme, subjekti fizik ose juridik, me aktivitetin e të cilit është shkaktuar rrezikimi dhe ndotja e mjedisit, është i obliguar që për këtë rast , menjëherë të njoftoj ministrinë përgjegjëse për mjedis, ministrinë përgjegjëse për siguri emërgjente si dhe prodhuesin e tregtuesin e këtyre materieve të rrezikshme.

6 Njoftimi duhet të përmbaj shenimet për rrethanat e aksidentit, vendin, kohën, llojin edhe sasinë e materieve të rrezikshme dhe masat e ndërmarrura

Neni 28

Mbrojtja e ajrit

1 Qeveria, në propozim të Ministrisë dhe duke marrë parasysh parimet e përsëritura në nenin 5. do të nxjerrë një akt plotësues normativ që themelon nivelet maksimale të lejueshme të shkarkimit dhe shpërndarjes të ndotësve në ajër. Qeveria do të sigurojë që nivelet e themeluara me aktim plotësues normativ janë konform me mundësinë e Kosovës të përballojë këto me një kosto të

arsyeshme. Qeveria do të ketë autoritet të ulë maksimumin e lejimit të shpërndarjes dhe shkarkimit që të mund, gradualisht ta sjellë në nivelin e EU-së.

2 Mbrojtja e ajrit zbatohet në nivel vendi, në bazë të Programit për mbrojtjen e ajrit, në pajtim me nenin 8. të këtij ligji, me të cilin, përveq tjerash, përcaktohen procedurat dhe afatet për arritjen graduale të standardeve teknike dhe normave të vlerave të kufizuara.

3 Subjektet, të cilat disponojnë me burim të ndotjes së ajrit /ndotësit e ajrit /, janë të obliguara që me masa tekniko-teknologjike dhe me masa tjera, të sigurojnë që shkarkimet dhe shpërndarjet në ajër të jenë në kufinj të vlerave të përkufizuara dhe përcaktuara me ligj dhe akte tjera.

Neni 29

Mbrojtja e ujit

1 Qeveria, në propozim të Ministrisë dhe duke marrë parasysh parimet e përshkruara në nenin 5. do të nxjerrë një akt plotësues normativ që themelon nivelet maksimale të lejueshme të shkarkimit dhe shpërndarjes të ndotësve në ujë. Qeveria do të sigurojë që nivelet e themeluara me aktin plotësues normativ janë konform me mundësinë e Kosovës të përballojë këto me një kosto të arsyeshme. Qeveria do të ketë autoritet të ulë maksimumin e lejimit të shpërndarjes dhe shkarkimit që të mund, gradualisht ta sjellë në nivelin e EU-së.

2 Duke respektuar standartet dhe rregullat e mbi vlerat e përkufizuara të ndotjes së ujit, ndalohet:

- (a) shkarkimi në ujëra e materieve toksike dhe jotoksike, të ngurta, të lëngëta, ose të gazta, organizmave të gjallë duke përfshirë edhe orgonizmat e modifikuar gjenetikisht dhe formave të energjisë që shkaktjnë ndryshimin e kthjellësisë, dekantimit, shtresimit dhe aromës ose ndryshime të tjera në cilësinë e ujit;
- (b) shkarkimi në sistemet publike të kanalizimit, e ujërave tëndotura të cilat përmbajnë substanca mbi vlerat e përkufizuara ose materiale të tilla të dëmshme të cilat mund të shkaktjnë probleme në sistemet e kanalizimit ose objekteve për pastrimin e ujit; dhe
- (c) përdorimi i puseve të braktitura si gropa septike për ujra tëndotura.

3 Me qëllim të përcjelljes së gjendjes së ndotëshmërisë së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, Instituti hidrometeorologjik i Kosovës, në kuadër të AKMA dhe nën autoritetin e Ministrisë, bënë hulumtimet sistematike të tyre, në bazë të dispozitave nenligjore, ndërsa për njohurit e ndotjes akcidentale të ujërave, duhet menjëherë të njoftoi organet e inspekcioneve pranë ministrive kompetente.

4 Akti plotësues normativ i nxjerrë në bazë të paragrafit 1 mund të kërkojë nga ndërmarrjet e mëdha industriale dhe autoritetet publike që shkarkimi dhe ndotja në ujë dhe rjetin e ujit publik, ku është e nevojshme, të instalojnë mjetet e nevojshme masin dhe/ose regjistrojnë llojin dhe kuantitetin e shkarkimit dhe vazhdimisht t'i ofrojnë Ministrisë këto informata.

Neni 30Mbrojtja e tokës

1 Qeveria, pasi që ka marë propozimin nga Ministri dhe duke marë parasysh principet e përshkruara në nenin 5, do të nxjerë një akt plotësues normativ që themelon nivelet maksimуме të lejueshme të shkarkimit dhe shpërndarjes të ndotësve në tokë. Qeveria do të sigurojë që nivelet e themeluara me aktim plotësues normativ janë konform me mundësinë e Kosovës të përballojë këto me një kosto të arsyeshme. Qeveria do të ketë autoritet të ulë maksimumin e lejimit të shpërndarjes dhe shkarkimit që të mund, gradualisht ta sjellë në nivelin e EU-së.

2 Subjektet juridike dhe fizike që me aktivitetet e tyre bejnë hulumtimin dhe shfrytëzimin e burimeve natyrore, grumbullimin e mbeturinave, hirit, zgjyrës, ose materialeve tjera, ose që kryen aktivitete tjera të cilat e degradojnë shtresën prodhuese, ose shkaktajnë erozion të tokës apo ndryshim në regjimin e ujit, duhet të riformojnë shtresën sipërfaqësore të tokës, rivendosin regjimin e mëparshëm ujqor dhe stabilitetin gjeo-mekanik të tokës, gjatë veprimtarisë dhe pas përfundimit të këtyre aktiviteteve, sipas projektit për mbrojtje dhe rikultivim të miratuar nga Ministri në pajtim me Ministrin përgjegjës për Bujqësi.

Neni 31Mbrojtja nga zhurma

1 Për zbatim të ligjit, Ministria, nxjerr dispozitat me të cilat rregullohet niveli i lejuar i zhurmës në mjedis, metodologjinë e matjes së zhurmës, standardet e paisjeve për matjen e zhurmës, kushtet që duhet plotësuar subjektet e liçencuara për matjen e zhurmës dhe vibrimeve si dhe përmbajtja e dokumentit për burimet e zhurmës që vehen në qarkullim.

2 Komunat, në kuadër të kompetenceve të tyre, nxjerrin aktin dhe ndërmarrin masat për mbrojtjen nga zhurma dhe për këtë qëllim në aktet e tyre të planifikimit hapsinor i caktojnë zonat e vendbanimeve, zonat për pushim dhe rekreacion si dhe sigurojnë matjet sistematike të zhurmës dhe vibrimeve.

3 Dokumentacioni teknik për ndërtimin e objekteve industriale, rrugëve magjistrale, dërtimin e hekurudhave,, aeroportëve dhe burimeve tjera të zhurmës dhe vibrimeve, duhet patjetër të përmbajnë zgjidhje teknike për mbrojtje nga zhurma dhe nga vibrimet dhe ti nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis.

Neni 32Mbrojtja nga rrezatimi jonizues dhe radioaktiviteti

1 Me qëllim të zbulimit të prezences, përcaktimit të rrezikshmërisë, informimit dhe ndërmarrjes së masave mbrojtëse nga rrezatimi jonizues, sipas kushtve dhe procedurës së paraparë nga ministrinë relevante, behët hulumtimi sistematik dhe monitorimi i përberjës së radionukleideve /materieve radioaktive / në ajër, në tokë, në lumenj dhe liqenj, i të reshurave atmosferike, të

bimëve dhe kafshëve, materialit ndërtimor, ujit të pijës dhe të produkteve ushqimore dhe ato në rrethana të rregullta, në rastet e dyshimit të bazuar dhe në rastet e jashtëzakonshme.

2 Hulumtimet nga paragrafi 1.i këtij neni si dhe monitorimet tjera me rëndësi të veçantë për vlerësimin e rrezikshmërisë radioaktive të popullsisë dhe të mjedisit, e bëjnë institucionet e licencuara nga ministritë përgjegjëse.

3 Institucionet e licencuara, të cilat kryejnë hulumtime sistematike të përberjes radioaktive të materieve në mjedis dhe matjet e intenzitetit të rrezatimit, janë të obliguara që raportet nga monitorimet e kryera t'ia dërgojnë ministrive përgjegjëse.

4 Qeveria me propozim të Ministrit do të nxjerrë akt të veçantë me të cilin do t'i caktoj kriteret dhe masat që duhet ndërmarë për t'u realizuar mbrojtja nga rrezatimi jonizues dhe radioaktiv.

KAPITULLI IV. **MBROJTJA E NATYRËS**

Neni 33

Zonat e mbrojtura të natyrës

1 Zonat me vlera të veçanta natyrore, që janë me interes ndërkombëtar, kombëtar, regjional dhe komunal për Kosovën, gëzojnë mbrojtje të veçantë me ligj.

2 Mbrojtja dhe ruajtja e terësishme e natyrës, shfrytëzimi i qëndrueshëm i vlerave natyrore, kategorizimi i zonave me vlera të veçanta sipas Konventave relevante ndërkombëtare, procedurat e vënies nën mbrojtje, mbrojtja e llojeve të rralla e të rrezikuara të florës dhe faunës, regjimi i mbrojtjes sipas shkallës së kategorizimit, mënyra e menagjimit të tyre, pjesëmarrja e publikut në vendimmarrje mbi natyrën si dhe mbikëqyrja profesionale e zonave me vlera të veçanta të natyrës, rregullohen me ligj të veçantë

Neni 34

Mbrojtja e diversitetit biologjik

1 Qeveria, pasi të ketë marr mendimet e Institutit për natyrë dhe mbrojtjes të mjedisit në kuadër të AKMM-së, do të ketë kompetenca për të nxjerr akte normative plotësuese që mundësojnë masa të arsyeshme për ruajtjen e diversitetit biologjik në Kosovë. Këto masa do të implementohen nga Instituti për natyrë dhe mbrojtje të mjedisit.

2 Funkcionet për mbrojtjen ndaj diversitetit biologjik nga ana e Institutit për natyrë dhe mbrojtje të mjedisit në kuadër të AKMM-së, përfshinë pa kufizim:

- (a) percaktimin e kriterëve dhe kushteve për inventarizimin në baza shkencore të

lojeve te rralla e te rrezikuara te flores dhe te faunes dhe ekosistemeve te ndieshme , te cilave u kanoset shfarosja ,dëmtimi i përhërshe apo degradimi;

- (b) identifikimin e problemeve qënesore dhe te prioriteteve ne kujdesin, mbrojtjen dhe shfrytëzimin e qendrueshëm te diverzitetit biologjik;
- (c) vlerësimin e gjendjes dhe tendencave të ndryshimit të biodiversitetit me qëllim të hartimit te programit të masave dhe aktiviteteve për mbrojtjen dhe përparimin e biodiversiteti;
- (d) hulumtimin dhe percjelljen permanente te gjendjes se biodiversitetit, te komponenteve te tij gjenetike dhe larmisë se llojeve si dhe të ekosistemit, me qëllim të ruajtjes, përtritjes dhe shfrytëzimit në baza ekologjike.

KAPITULLI V: **MONITORIMI DHE INFORMIMI MBI MJEDISIN**

Neni 35 Monitorimi i mjedisit

1 Monitorimi i gjëndjes së mjedisit zbatohet në nivel vendi, nga Ministria përmes Agjensionit të Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit /AKMM/, e cila siguron vëzhgimin e përhërshem të mjedisit, të gjendjes dhe karakteristikave të vlerave të natyrës, në hapësirë dhe në kohë të caktuar, vëzhgimin e degradimit me përdorimin e resurseve natyrore si dhe ndikimin e tyre në shëndetin e njeriut.

2 Agjensioni është përgjegjës edhe për grumbullimin dhe sistemimin e të dhënave bazike dhe indikatorëve tjerë për mjedis, të dhënave nga subjektet përgjegjëse për ndotje dhe çrregullim të mjedisit duke përfshirë ujin, ajrin, tokën, diversitetin biologjik, florën dhe faunën, elementet klimatike, atmosferën, rrezatimit jonizues dhe jojonizues, si dhe materieve të dëmshme e të rrezikshme në mjedis.

3 Të dhënat e grumbulluara nga monitorimi i gjendjes së mjedisit përbëjnë informacion publik dhe përfshihen në Sistemin Informativ të mbrojtjes së mjedisit. Këto të dhëna publikut i bëhen të njohura nëpërmjet mediave publike ose formave tjera të informimit publik.

4 Ministri përgjegjës për mjedis, me akt të veçantë, cakton kriteret për përcaktimin e stacioneve vëzhguese, sasinë dhe shpeshësinë e matjeve,klasifikimin e dukurive të cilat vëzhgohen, metodologjinë e punës si dhe formën dhe kohën e raportimit të të dhënave.

Neni 36 Monitorimin i shkarkimit, shpërhapjes dhe regjistrimi i të dhënave

1 Çdo personi, ndërmarrje apo autoritet publik që është përfshirë në aktivitete të vazhdueshme që është vendosur se do të shkaktojnë dëm të madh apo kritik mjedisor, mund , deri në momentin që pala e tillë ka marë masa permanente për të siguruar se shkarkimi dhe shpërndarja që shkaktojnë dëm më të madh apo kritik mjedisor, janë në pajtim me nivelet maksimуме të përshkruara në fuqi, Ministria do të kërkojë prej tyre që:

- (a) të sigurojnë organizimin e monitorimit të shkarkimeve vetanake,
- (b) pjesmarje në monitoringun e efekteve që shkaktojnë shkarkimet dhe shpërndarjet në rajonet të ndikuara direkt.
- (c) të mbajnë të dhëna për ndotjen e mjedisit të cilat duhet të përmbajnë të dhëna për energjinë dhe materialet e konsumuara së bashku me natyrën e çrregullimit mjedisor si dhe
- (d) mirmbajë llojet dhe kuantitetin e ndotjes të bërë ose shpërndarë, substancave të rezikshme apo mbeturinave të rezikshme, si dhe në natyrën e dëmeve të mëdha apo kritike mjedisore.”

2 Të dhënat e parapara me paragrafin 1. të këtij neni, subjektet përgjegjëse për çrregullim mjedisor, janë të obliguar të ia dërgojnë Agjensionit të Kosovës për mjedis.

3 Ministri, me akt të veçantë përcakton përmbajtjen dhe metodën e mbajtjes së të dhënave, mënyrën e paraqitjes së të dhënave, metodat e mikqyrjes së shpërhapjes, formën dhe kohën e raportimit të të dhënave të monitorimit dhe paisjet e duhura për monitorim.

Neni 37

Sistemi i informativ për mbrojtjen e mjedisit

1 Me qëllim të vëzhgimit, evidentimit të vlerave natyrore dhe qeverisjen me mjedis, Ministria përmes AKMM, krijon, organizon dhe mbanë Sistemin Informativ për Mbrojtjen e Mjedisit.

2 Sistemi Informativ për Mbrojtjen e Mjedisit , përfshin informacionet pa kufizim, për:

- (a) burimet natyrore ;
- (b) çrregullimet tepër të mëdha apo kritike mjedisore;
- (c) përdorimi i materialeve dhe energjisë;
- (d) substancat e dëmshme dhe të rezikshme;
- (e) origjina dhe shpërndarja e mbeturinave;
- (f) shpërhapja sipas burimeve të tyre;
- (g) personat përgjegjës për çrregullimet tepër të mëdha apo kritike ;
- (h) masa dhe programe rehabilitimi;
- (i) dëmtimet e mjedisit dhe aksidentet ekologjike;
- (j) kushtet shëndetësore dhe ekologjike të popullsisë;
- (k) zonat e mrojtura të natyrës;
- (l) masat e diversitetit biologjik;
- (m) regjistri i tipareve të rëndësishme natyrore;

- (n) tipi dhe deponimi dhe
- (o) çështje të tjera të mjedisit që kanë lidhje me të ose kërkohen nga ky ligj.

3 Ministria dhe komunat mbajnë të dhëna, të cilat nuk janë pjesë e sistemit informativ për mbrojtjen e mjedisit, të cilat përfshijnë pa kufizim:

- (a) gjithë subjektet që ndërmarrin veprimtari të autorizuara dhe veprimtarite e tyre;
- (b) kërkesat për miratim, licencat dhe autorizime të tjera të tilla që kërkohen e jepen dhe çdo informacion të mëtejshëm në lidhje me to;
- (c) çfarëdo informacioni tjetër të marrë ose siguruar sipas dispozitave të këtij ligji apo akteve plotësuese normative;
- (d) hollësi për gjopa të vendosura sipas këtij ligji dhe akteve plotësuese normative.

Neni 38

Baza e të dhënave të ndotësve - kadastrit

1 Për caktimin e karakteristikave dhe ndikimit të ndotësmerisë në cilësinë e ajrit, të ujit dhe tokës e veqanrisht në zonat e mbrojtura të natyrës dhe pasqyrimin analitik të tyre, evidentimit të subjekteve përgjegjëse për ndotje si dhe si dhe mbajtjen e regjistrit të materieve të dëmshme dhe të rrezikshme, Ministria mbanë kadastrin e ndotësve në nivel të Kosovës.

2 Ministria e mjedisit, përcakton dhe nxjerr Udhëzimin për:

- (a) formen dhe përmbajtjen e kadastrit të ndotësve të ajrit, të ujit dhe tokës dhe objekteve të natyrës, dhe
- (b) regjistrin e materieve të dëmshme dhe materieve të rrezikshme

KAPITULLI VI:

INSTITUCIONET PËR MBROJTJEN E MJEDISIT

Neni 39

Agjencioni i Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit

1 Agjencioni i Kosovës për mbrojtjen e Mjedisit, i themeluar me këtë ligj, është institucion që përfshinë Institutin hidrometeorologjik dhe Institutin për mbrojtjen e natyrës dhe mjedisit, nën autoritetin e Ministrisë, për kryerjen e punëve administrative, profesionale, mbështetëse, shkencore dhe kërkimore në fushën e mbrojtjes së mjedisit, zonave të mbrojtura të natyrës, të diversitetit biologjik dhe në fushën hidrometeorologjike.

2 Detyrat administrative të AKMM-së janë:

- (a) dhënja e mendimit në procedurën e vlerësimit të raportit mbi ndikimin e aktiviteteve në mjedis në miratimin e pëlqimeve mjedisore për lejet e ndërtimeve;
- (b) organizimi i monitorimit të gjendjes së mjedisit ;

- (c) dhënjen e mendimeve në procedurën e miratimeve mjedisore për zona të mbrojtura të natyrës;
- (d) organizimin i sistemit informativ për mbrojtjen e mjedisit; dhe
- (e) detyra të tjera caktuara me ligj .

3 Detyrat profesionale, mbështetëse, shkencore dhe kërkimore të AKMM-së janë:

- (a) hartimi i propozimit të Strategjisë së Kosovës për mbrojtjen e mjedisit dhe përcjellja e zbatimit të saj pas miratimit nga Qeveria ;
- (b) përgatitja e Programeve të mbrojtjes së mjedisit nga fusha të veçanta dhe përcjellja e zbatimit të tyre pas miratimit nga Qeveria;
- (c) vlerësimin e akteve të planifikimit dhe rregullimit hapësinor;
- (d) përgatitja e raporteve për gjëndjen e mjedisit;
- (e) mbështetje shkencore dhe të tjera për përgatitjen e masave të mbrojtjes së mjedisit;
- (f) mbështetje shkencore dhe të tjera për mbrojtjen e diversitetit biologjik, zonat e mbrojtura të natyrës dhe masa të tjera mbrojtëse të natyrës;
- (g) përgatitjen e propozimeve për mirënjohje dhe shpërblime në fushën e mbrojtjes së ambientit;
- (h) projekte kërkimore dhe zhvillimi në lidhje me mbrojtjen e mjedisit;
- (i) përgatitje e materialit për mbrojtjen e mjedisit për qëllime edukative dhe ngritjes së ndërgjegjes publike për mjedisin;
- (j) monitorim , hulumtimi dhe informimi për atmosferën dhe hidrosferën duke përfshirë shërbimin e parashikimit meteorologjik dhe hidrologjik;
- (k) përcjellja e zhvillimit e teknologjive të pastërta lidhur me mjedisin; dhe
- (l) detyra të tjera të caktuara me ligj.

Neni 40

Bordi Këshillues për mbrojtjen e mjedisit

- 1 Kuvendi i Kosovës emëron Bordin Këshillues për Mbrojtjen e Mjedisit (në tekstin e mëtejme: Bordi) për të këshilluar Kuvendin dhe Qeverinë për çështje të mbrojtjes së mjedisit.
- 2 Bordi përbëhet nga shtatë anëtarë të emëruar nga Kuvendi. Anëtarët e Bordit, zgjedhen nga ekspertë dhe shkencëtarë të dalluar në fushën e mbrojtjes së mjedisit. Anëtari i Bordit nuk duhet të jetë i punësuar në Ministrinë përgjegjëse për mjedis.
- 3 Bordi është i pavarur nga çdo autoritet tjetër.
- 4 Bordi jep mendime dhe sugjerime për Kuvendin dhe Qeverinë dhe informon publikun për çështjet e mëposhtme:
 - (a) gjëndjen e mjedisit dhe trendet në fushën e mbrojtjes së mjedisit;

- (b) strategjinë dhe politikën për mbrojtjen e mjedisit dhe koordinimin e tyre me trendet ndërkombëtare;
- (c) harmonizimin mes zhvillimit ekonomik dhe mbrojtjes së mjedisit;
- (d) ligjet që rregullojnë mbrojtjen e mjedisit;
- (e) veprimtarinë e ministrive përgjegjëse dhe aktivitetet e komunave në fushën e mbrojtjes së mjedisit;
- (f) iniciativat publike dhe
- (g) funksione tjera të përcaktuara me ligj .

Neni 41

Fondi i Kosovës për Mjedisin

1. Do të themelohet fondi i njohur si Fondi i Kosovës për Mjedis (në tekstin e mëtejshëm: “Fondi”). Fondi do të jetë në zhiro llogari të ndarë mbrenda Fondit të Konsoliduar të Kosovës.
2. Mjetet në xhirrollojarinë e Fondit do të shfrytëzohen vetëm për përmirsimin e mjedisit, minimizimin e përqëndrimeve me ndotje të rezikshme, dhe promovimin e mbrojtjes të mjedisit.
 2. Fondi do të financohet nga:
 - (a) fonde nga publiku i përgjithshëm specifikisht të adresuara për Fondin në Buxhetit e Konsoliduar të Kosovës;
 - (b) të hyra nga taksat mjedisore të miratuara nga Kuvendi;
 - (c) gjobat, dënimet dhe taksat e autorizuara me këtë ligj dhe të hyrat nga ndotësit;
 - (d) çdo grant apo donacion specifikisht të dedikuara për Fondin.
4. Fondi nuk do të përdoret për të dhënë ndihma financiare apo kredira për ndonjë autoriteti publik, personi apo ndermarrjeje. Fondi do të jetë subjekt i kërkesave të Ligjit për menaxhimin publik financiar dhe standartet e kontabilitet. Çdo blerje e mallrave, shërbimeve, punëve apo pronës me para nga Fondi do të (i) përmbahet strikt rregullave dhe akteve normative plotësuese të ligjit për furzizim publik dhe (ii) duhet të jenë të lidhura direkt me qëllimet e specifikuar ne paragrafin 2 të këtij neni.

KAPITULLI VII:

MBIKQYRJA PROFESIONALE DHE INSPEKTIVE

Neni 42

Mbikqyrja profesionale

Mbikqyrjen në zbatimin e dispozitave të këtij Ligji dhe të akteve tjera të nxjerrura në bazë të ligjit, e bënë Ministria.

Neni 43Mbikqyrja Inspektive

- 1 Inspektoriati mjedisor do të jetë instucioni i themeluar brënda Ministrisë. Inspektorati mjedisor do të jetë përgjegjës për përmbushjen e detyrave specifike të deleguara për Inspektoriatin mjedisor me këtë ligj apo akte plotësuese normative të nxjera në mënyrë valide me këtë ligj.
- 2 Kryeinspektori dhe inspektorët përgjegjës për mjedis, emërohen nga Ministria dhe janë të pavarur në kryerjen e përgjegjësisë të përcaktuara me ligj .
- 3 Inspektorët legjitimohen përmes kartës së identifikimit, formën dhe përmbajtjen e së cilës me akt të veçantë, e cakton Ministri përgjegjës për mjedis.

Neni 44Autorizimet e Inspektorit të Mjedisit

- 1 Qeveria do të nxjerr akte plotësuese normative që themelojnë, deri në masë të arsyeshme dhe specifike, kompetencat, detyrat dhe përgjegjësitë të inspektorëve mjedisor. Gjatë nxjerrjes së akteve normative të tilla plotësuese Qeveria do të përfshijë siguri të nevojshme për të garantuar që inspektorët mjedisor nuk mund ta abuzojnë autoritetin e tyre apo të ndërmarrin akcione që tejkalojnë atë të nevojshmet për të përmbushur detyrat e tyre.

Neni 45Obligimet e inspektorëve për bashkëveprim

- 1 Në rastet kur inspektori i mjedisit në kryerjen e mbikqyrjes inspektive vlerëson se përveç shkëlqes së dispozitave të këtij ligji janë shkëlqur edhe dispozitat e ligjeve tjera me rëndësi për mbrojtjen e mjedisit është i obliguar që, krahas marrjes së masave për të cilat është i autorizuar, të njohton edhe organin tjetër kompetent në mënyrë që bashkarisht të kryejnë mbikqyrjen dhe të ndërmarrin masat e parapara me ligj.

Neni 46Autorizimet e inspektorit komunal për mjedis

- 1 Në ushtrimin e përgjegjësisë të mbikqyrjes inspektive në zbatimin e masave për mbrojtjen e mjedisit, inspektori komunal për mjedis, është përgjegjës për mbikqyrjen e çrregullimeve mjedisore të karakterit lokal, ndikimi i të cilave nuk kalon kufijtë e komunave dhe të cilat mund të zgjidhen, kontrollohen dhe parandalohen nga vetë komunat.

Neni 47Procedurat e Ankesës

- 1 Në procedurën e ushtrimit të mbikëqyrjes inspektive, në rastet e marrjës së masave për urdhëresa dhe ndalesa, inspektori i mjedisit, nxjerr vendim.
- 2 Kundër vendimit të inspektorit komunal për mjedis, ankesa i drejtohet organit kompetent komunal.
- 3 Në ankesën kundër vendimit të organit kompetent komunal respektivisht Inspektorit mjedisor në nivel të Kosovës, vendos Ministria.
- 4 Për zbatimin e dispozitave të këtij ligji do të aplikohen rregullat e procedurës së përgjithëshme administrative.

KAPITULLI VIII:**DISPOZITAT NDËSHKIMORE****Neni 48**Kundravajtjet

Të gjitha aktet plotësuese normative të nxjerra nga Qeveria në pajtim me këtë ligj do të përmbajnë dispozita që specifikojnë gjokat që mund të imponohen për kundravajtje. Cdo dispozitë mbi një gjobë të tillë të akteve plotësuese normative do të sigurojë që një gjobë e tillë është proporcionale gjer në masën dhe llojin e kundravajtjes relevante dhe deri në masën e dëmit të shkaktuar interesit nga një kundravajtje e tillë.

KAPITULLI IX:**DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE****Neni 49**Aktet e Qeverisë dhe aktet ministrore

- 1 Qeveria nxjerr aktet e parpara me këtë ligj në afatin prej 12 muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.
- 2 Ministrinë nxjerrin udhëzime të cilat janë të parpara me këtë ligj në afatin prej 18 muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.
- 3 Komunat dhe subjektet përkatëse i harmonizojnë aktet dhe aktivitetet e tyre me dispozitat e këtij ligji në afatin prej 24 muajve nga dita e hyrjes në fuqi .

4 Deri në nxjerrjen e akteve të parapara me paragrafët 1. 2. dhe 3. të këtij neni, aplikohen dispozitat e ligjit në fuqi.

Neni 50

E drejta në zbatim

1 Ky Ligj zëvendëson çdo dispozitë të së drejtës së aplikueshme që bie në kundërshtim me të.

Neni 51

Hyrja në fuqi

Ky Ligj hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Kosovës, nënshkrimit nga Kryetari i Kuvendit dhe shpalljes nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

16 Janar 2003

Kryetari i Kuvendit të Kosovës,

Akademik Nexhat daci